



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA FUSHË-ARRËZ
KËSHILLI BASHKIAK

Komisioni Këshillimor për dhënien e Titujve Vendorë të Nderit

PËR : KËSHILLIN E BASHKISË

FUSHË-ARRËZ

Nr. 3750 prot.

Fushë-Arrëz, më 17.11.2025

Lënda: Relacion lidhur me propozimin, për dhënie titulli "Qytetar Nderi" i Bashkisë Fushë-Arrëz, Z. Kol Toplana.

Komisioni Këshillimor, i ngritur me vendimin nr. 23, datë 30.10.2023 të Këshillit Bashkiak Fushë-Arrëz "për dhënien e dekoratave, titujve të nderit, medaljeve ose titujve vendor të nderit", u mbledh sot, më 17.11.2025 duke marrë në shqyrtim propozimin e një grupi me integritet në komunitet, për dhënien e titullit "Qytetar Nderi", për Z. Kol Toplana me motivacionin:

"Për kontributet e tij të veçanta si mbështetës i luftës nacionaliste dhe për rolin e tij të rëndësishëm në odat e pajtimit dhe zgjidhjen e mosmarrëveshjeve në komunitet, për virtytet e larta të fjalës, besës, ndershmërisë dhe mikpritjes, duke u bërë shembull i vlerave tradicionale dhe i harmonisë shoqërore".

Paraprkishtë Komisioni Këshillimor, bazuar në materialet argumentuese lidhur me arsyet e propozimit, Vendimin nr.444, datë 16.10.2025 të Autoritetit për verifikimin e figurës së Z. Kol Toplana, vendosi të miratojë propozimin e bërë, duke qenë se plotësohen kriteret sipas ligjit 94/2022. Ky relacion do t'i paraqitet Këshillit të Bashkisë në mbledhjen e tij të datës 27.11.2025. Këshilli do të bëjë shqyrtimin e mëtejshëm të propozimit dhe projektvendimit për dhënien e titullit vendor të nderit, "Qytetar Nderi" i Bashkisë Fushë-Arrëz të Z. Kol Toplana.

Komisioni Këshillimor

Gjevalin Alija

Pashk Prenga

Mustaf Pashkaj

Besjana Marku

Zef Cara



REPUBLIKA E SHQIPERISE
BASHKIA FUSHE-ARREZ
KESHILLI BASHKIAK

Komisioni i Arsimit, Kulturës, Sporteve dhe Rinisë, Trashëgimisë Kulturore, Dhënies së Titujve, Emërtimeve

Nr. 4044 Prot.

Fushe-Arrez, me 24.12.2025

PER : KESHILLIN E BASHKISE

FUSHE-ARREZ

**Relacion i Komisionit të Arsimit, Kulturës, Sporteve dhe Rinisë, Trashëgimisë Kulturore, Dhënies së Titujve, Emërtimeve mbi shqyrtimin e projektvendimit për PËR DHËNIE TITULLI "QYTETAR NDERI" I BASHKISË FUSHË-ARRËZ
Z. KOL TOPLANA PAS VDEKJES**

Ne zbatim të ligjit 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", i ndryshuar, u mbledh sot, me 24.12.2025, Komisioni i të Arsimit, Kulturës, Sporteve dhe Rinisë, Trashëgimisë Kulturore, Dhënies së Titujve, Emërtimeve, dhe u shqyrtua projektvendimi për dhënie titulli "Qytetar Nderi" i Bashkisë Fushë-Arrëz, Z. Kol Toplana pas vdekjes.

Anetaret e komisionit u njohën me materialet shkresore fizike ku me heret ishin njohur edhe përmes faqes web të bashkisë konkretisht me: Propozimin për Qytetar Nderi, CV, Dokumenti I Autoritetit të dosjeve lidhur me pastertinë e figures së Z. Kol Ded Toplana, Relacionin e komisionit të keshillimit me motivacionin etj.

Ne Relacionin Shpjegues, Sektori i Burimeve njerëzore, dhe Juridike, Fushë-Arrëz, u propozon anëtarëve të Këshillit të Bashkisë që të vlerësohet figura dhe personaliteti i Z. Kol Ded Toplana, duke iu dhënë titulli i nderit në shenjë respekti dhe mirënjohje publike për të gjithë kontributin dhe punën në funksion të komunitetit:

T'i jepet titulli "Qytetar Nderi" i Bashkisë Fushë-Arrëz, Z. Kol Ded Toplana me motivacionin: "Për kontribut të jashtëzakonshëm në çështjen kombëtare, zhvillimin ekonomik të zonës, ruajtjen e traditës dhe kulturës shqiptare, pajtimin e gjaqeve, shërbimin ndaj komunitetit dhe rolin e tij si figurë shembullore e ndershmërisë, urtësisë dhe vlerave më të larta qytetare".

Ky titull jepet në shenjë nderimi dhe vlerësimi për gjithë kontributin dhe përkushtimin e tij si mbështetës i luftës nacionaliste dhe për rolin e tij të rëndësishëm në odat e pajtimit dhe zgjidhjen e mosmarrëveshjeve në komunitet, për virtytet e larta të fjalës, besës, ndershmërisë dhe mikpritjes, duke u bërë shembull i vlerave tradicionale dhe i harmonisë shoqërore.

Z. Kol Ded Toplana njihet nga banorët e trevës si njeriu model i vlerave të traditës, kulturës, dhe atdhetarizmit.

Për të gjitha meritat propozohet t'i akordohet titulli "Qytetar Nderi i Bashkisë Fushë-Arrëz".

Anetaret e komisionit në këtë mbledhje ishin dakord me gjithçka kishte projektvendimi dhe me shumicë votash vendosën ta dergojnë projektin për shqyrtim dhe miratim në mbledhjen e datës 26.12.2025.

PER KOMISIONIN

Benjana Marku
25

Franc Doda

Toneze Demq
Hana